



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:101541
Datë: 24.03.2023
Numri i dokumentit: 04117892

Ac.nr.5189/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore paditëses S. K. nga fshati B., K. e M., të cilën e ka përfaqësuar avokat A. K. nga M., ndaj të paditurës Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit të cilën e ka përfaqësuar Avokati Publik Komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, departamenti i Përgjithshëm, C.nr.205/2020 të datës 07.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.205/2020 i datës 07.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë më Aktgjykimin e ankimuar C.nr.205/2020 të datës 07.06.2021, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses S. K. nga fshati B., Komuna e M., në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën- Komunën e Malishevës – DKAE, që paditëses S. Kr. nga fshati Bubavec, Komuna e M. në emër të shujtës ditore dhe atë për 555 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 e deri 18.04.2020, të përlllogaritur sipas shumë prej 2 euro në ditë t’ia paguaj shumë e përgjithshme prej **1,110.00 euro**, me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 07.06.2021, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbaramit të detyrueshëm, ndërsa në pikën e tretë të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 260 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbaramit të detyrueshëm

Kundër këtij Aktgjykimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim si në të njëjtën.

Pala paditëse ka paraqitur përgjigje në padi, me anë të së cilës ka kundërshtuar ankesën e të paditurës Komuna e Malishevës, me propozim si në të njëjtën.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, S. K. nga fshati B., Komuna e M., përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit lidhur me kompensimin e shujtave ditore pasi që paditësja është e punësuar në SHFMU “Dëshmorët e Fshatit Bubavec” në Bubavec-Komuna e Malishevës sipas Kontratës së Punës, e cila ka 26 vite përvojë pune. E punësuar ka paraqitur kërkesë për pagimin e shujtës nga data 18.04.2017, 2018, 2019 dhe 2020 tek Drejtoria për Arsim e Komunës së Malishevës, por ende nuk ka pranuar përgjigje lidhur me kërkesën, edhe pse ka kaluar afati ligjor prej 30 ditësh, andaj pas precizimit të kërkesëpadsisë, gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesëpadsisë si të bazuar, dhe ta detyrojë të paditurën që prej datës kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit datë 18.04.2017 e deri në kohëzgjatjen e saj tre vjeçare sipas Ligjit të Punës përkatësisht për këtë periudhë kohore paditësja ka 555 ditë pune, e që në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të kësaj kontrate për një ditë pune paditëses i takon 2 euro, andaj duke llogaritur 555 ditë pune nga dy euro në ditë të detyrohet e paditura t’i kompensojë paditëses shumën e përgjithshme prej 1,110.00 euro me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë në emër të parashtrimt të padisë shumën prej 104.00 euro në emër të taksës shumën prej 21.00 euro dhe në emër të përfaqësimit për një seancë nga avokati 135.00 euro.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi. I autorizuari i të paditurës Avokati Publik Komunal gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë e ka kontestuar padinë e paditëses si të pabazuar për faktin se Komuna nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017, por kjo kontratë ka qenë e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës- MASHT, andaj për këtë kategori Komuna nuk ka ndarë buxhet dhe nuk ka mundur të planifikojë mjete për shlyerjen e këtyre obligimeve pasi që kjo është dashtë të parashihet nga niveli qendror, Ministria e Arsimit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, ndërsa ka kërkuar nga gjykata që shpenzimet e paditësit t’i refuzohen.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore, dhe ka administruar provat ku është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune

tek e paditura si mësimdhënëse në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Dëshmorët e Fshatit Bubavec” në Bubavec, por të njëjtës nuk i janë kompensuar mjetet në emër të shujtave ditore edhe pas kërkesës së paditëses për kompensimin e të njëjtës, për periudhën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Sipas dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 të lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK lidhur me kompensimin në emër të shujtës ditore, sipas neni 35 paragrafi 7 përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Sipas neni 8 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e neni 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, andaj, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që paditëses t’ia aprovojë kërkespadinë sipas periudhës prej 18.04.2017 – 18.04.2020 përkatësisht për 555 ditë punë nga dy euro, periudhë gjatë të cilës paditësja ka punuar tek e paditura duke e detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pretendimet e të autorizuarit të të paditurës i konsideroi si të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në neni 2 paragrafi 1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e paragrafit 1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë u bazua në dispozitat ligjore të neni 35 paragrafi 7 , neni 2 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, neni 8 dhe neni 245 paragrafi 1 të LMD-së, për sa i përket kamatës ligjore gjykata e shkallës së parë iu referua neni 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa për sa i përket shpenzimeve procedurale u referua në neni 452.1 të LPK-së dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi

2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike e as shkeljeve të tjera nga neni 181.1 dhe 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura. Nuk është kontestuese as e drejta e paditëses për kompensimin për ushqim sepse bazuar në nenin 35 paragrafi 7 *“të punësuarve iu sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se aktgjykimi është përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë dhe duke bazuar në ligj e ka zbatuar të drejtën materiale. Pretendimet ankimore e të paditurës se paditësja ka kërkuar kompensimin e shujatave ditore edhe përtej afatit sa ka qenë kontrata kolektive në fuqi pasi kjo kontratë ka skaduar me datën 18.04.2020 andaj kemi të bejë me parashkrim të borxhit sepse kontrata kolektive e arsimit ka qenë e lidhur në afat prej 3 vite sipas nenit 90 të Ligjit të punës, gjykata e apelit i refuzon si të pabazuara nga fakti se sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me ligjin e aplikueshëm, marrëveshjen e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale me numër 40/2023 të datës 27.02.2023, në pikën I theksohet se *“për mardhëniet e punës që kanë lindur pas datës 15.12.2010, zbatohen dispozitat e ligjit të punës”* ndërsa sipas pikës IV *“Kontrata Kolektive e Arsimit e Kosovës e lidhur me datën 18.04.2017 dhe e nënshkruar nga Organizata e të Punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Minsitria e Arsimit Shkencë dhe e Teknologjisë) aplikohet për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 21.01.2021”*, ky rast i referohet mardhënies juridike civile që ka lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 17.04.2017 e ku sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës skadon me datën 21.01.2021 andaj nuk kemi parashkrim të borxhit e as padi të pas afatshme.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shujatave ditore në shumën si në aktgjykimin e atakuar, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive në Kosovë, të lidhur dhe të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për

punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e kompesimine shujtave ditore që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë. Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelsinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5189/2021, me datë 20.03.2023

Kryetar i kolegjit,
Ardian Ajvazi